



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:217892

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05749202

KF.nr.338/2022

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me zyrtaren ligjore Amire Jahiri në cilësi të procesmbajtëses në kontestin tregtar administrativ të paditësit Shoqëria “Auloni” sh.p.k, me seli në Fushë Kosovë, Zona Industriale 4, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Y.B., nga Prishtina, kundër të paditurit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti rivlerësim malli, vlera e kontestit 10,016.27 €, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik, të mbajtur në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, Y.B. dhe të përfaqësueses së autorizuar të palës së paditur, Blerta Gagica, me datë 03.05.2024 mori, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Shoqëria “Auloni” sh.p.k, me seli në Fushë Kosovë.
- II. ANULOHET aktvendimi me nr.01.3.2.2/746/2019 i datës 31.08.2021 i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. OBLIGOHET e paditura Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit Shoqëria “Auloni” sh.p.k, me seli në Fushë Kosovë, t’ia kthej shumën prej 10,016.27 €, të paguar më tepër në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratave Unike Doganore me nr. R-68754/19.11.2018 dhe R-68759/19.11.2018 dhe R-68842/20.11.2018, të proceduar në ZBD Prishtinë, si dhe shumën prej 4,070.17 €, në emër të kamatës ligjore nga dita e ushtrimit të padisë së parë datë 19.02.2019, e deri në ditën e përpilimit të ekspertizës datë 18.03.2024, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.
- IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi Shoqëria “Auloni” sh.p.k, me seli në Fushë Kosovë, Zona Industriale 4, me padinë e paraqitur në Gjykatë, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë për anulimin e vendimit nr.01.3.2.2/746/2019 të datës 31.08.2021. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i paditësit deklaroi se: Kemi pranuar ekspertizën financiare nga eksperti J.S., dhe konsiderojmë se ekspertiza është përpiluar me perimetra korrekt dhe objektiv për çka nuk kemi as vërejte dhe as propozime shtesë. Bazuar në të gjeturat e ekspertit përshkruar në konstatim dhe mendim, paditësi ri-precizon padinë dhe kërkesëpadinë ashtu që lartësia e shumës e cila të paditurës i është paguar në emër të taksës mbrojtëse nuk është shuma e përshkruar në kërkesëpadi, por është shuma 10,016.27 €, si dhe kamatëvonesa e llogaritur për periudhën kohore nga dita e depozitimit të padisë së parë pranë gjykatës, e deri në ditën e përpilimit të ekspertizës konsiston të jetë shuma 4,070.17 €. Mbetem në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, shpjegimeve të artikuluar me parashtrësia të veçanta si dhe deklaratimet e drejtpërdrejta në seancat e mbajtura para kësaj gjykate, me propozimin se kërkesëpadija e paditësit të aprovohet si e bazuar, aktvendimi i goditur nr.01.3.2.2/746/2019 i datës 31.08.2021, të anulohet si akt administrativ i nxjerrë në kundërshtim me vendimin e Qeverisë së Kosovës nr.01/74 mbi bazën e së cilës e paditura pa të drejtë përlllogarit dhe inkason në emër të taksës shtesë shumën e precizuar sot në këtë seancë. Shpenzimet e procedurën i kërkon.

E paditura, në përgjigje në padi e konteston në tërësi si të pa bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se aktvendimi i atakuar është marr konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marr me shkelje ligjore nuk qëndron fare me arsyetimin se vendimi i atakuar është marr konform legjisllacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë, ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka arsyetuar as edhe me një provë të vetme relevante juridike. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor përfaqësuesi i autorizuar i palës së paditur deklaroi se: Mbesim në tërësi pranë përgjigjes në padi si dhe të thënave nga seancat e kaluara. E kemi pranuar ekspertizën financiare, e të cilën e kundërshtojmë, për arsye se interpreton mendimet e Qeverisë, për të cilat nuk ka kompetencë që të bëjë interpretime të tilla dhe për një gjë të tilla është kompetencë Zyra e Kryeministrit dhe gjykatës që të vlerësoj këto vendime. Andaj, e kundërshtojmë në tërësi mendimin dhe konstatimin e ekspertit sikurse në ekspertizë. Duke u bazuar në thëniet e lartcekura dhe në të thënat nga seancat e kaluara si dhe në shkresat e lëndës, e paditura i propozon gjykatës që të merr aktgjykim me të cilin refuzohet në

tërësi si e pa bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit dhe ta lë në fuqi aktvendimin e të paditurës si të drejte dhe të ligjshëm. Shpenzimet e procedurën nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor-publik të datës 03.05.2024, ka administruar provat dhe atë: aktgjykimi A.nr.427/19 i datës 21.06.2021, aktvendimi 01.3.2.2/746/2019 i datës 31.08.2021, vendimi i Entit Shtetëror të Pronësisë Intelektuale të Republikës së Kroacisë i datës 06.04.2016, deklarata e shoqërisë tregtare ZVIJEZDA së bashku me të dhëna lidhur me përkrahimin e brendit, pronësinë, prodhuesin dhe kontaktin, kontrata për licencim e datës 28.12.2017, së bashku me të dhënat lidhur me përkrahimin dhe dukjen e markave tregtare- produkteve përkatëse, përgjigja në padi e datës 29.03.2022, DUD-at 68842/20.11.2018, 68754/19.11.2018, 68759/19.11.2018, EUR1 nr.6298390, nr.6348191, nr.6533175, faturat nr.4/3191, nr.1184615903, 1184615902, 1184618278, certifikata e regjistrimit në ARBK, së bashku me informatat mbi biznesin, parashtrësia e MTI e datës 29.11.2018, vendimi i Qeverisë nr.01/74 i datës 06.11.2018, vendimi i Qeverisë nr.01/76 i datës 21.11.2018, së bashku me aneksin 1, list distribuimi i Doganës i datës 10.08.2021, aktvendimi 746/17.01.2019 si dhe ekspertiza financiare e datës 18.03.2024.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Në këtë procedurë gjyqësore të kontestit tregtar - administrativ në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se subjektit në procedurë "Auloni" sh.p.k, me seli në Fushë Kosovë, këtu paditësi, përmes DUD-ave R-68754/19.11.2018, R-68759/19.11.2018 dhe R-68842/20.11.2018 të ZBD Prishtina, nuk i është pranuar beneficioni mbi lirim nga taksat doganore për mallrat me origjinë nga Serbia. Nuk është kontestues as fakti se paditësi ka ushtruar ankesë në Doganën e Kosovës, e për të cilën ankesë e paditura me datë 17.01.2019 ka sjell aktvendimin nr.01.3.2.2/746, me të cilin e ka refuzuar ankesën e këtu paditësit për rishqyrtimin e DUD-ave të lartcekur. Tutje lidhur me këtë lëndë Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, duke vendosur sipas padisë së paditësit me Aktgjykimin A.nr.427/19 të datës 21.06.2021 e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, e ka anuluar

aktvendimin nr.01.3.2.2/746, të datës 17.01.2019, dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim – rivendosje, ndërsa e paditura duke vepruar sipas këtij Aktgjykimi, në rishqyrtim dhe rivendosje ka sjell aktvendimin nr.01.3.2.2/746/2019 të datës 31.08.2021, me të cilin përsëri ka refuzuar kërkesën e këtij paditësit, e ndaj të cilit aktvendim paditësi me padinë e datës 29.09.2019, ka iniciuar këtë kontest tregtar - administrativ.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Dogana e Kosovës ka konstatuar se Sektori i Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur ka obliguar subjektin për taksë doganore 10% si dhe masën mbrojtëse të caktuar sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.01/74 të datës 16.11.2018, pasi që sipas këtij vendimi brendi – malli i importuar me DUD-at R-68759/19.11.2018, R-68754/19.11.2018 dhe R-68842/20.11.2018, nga Dogana e Kosovës nuk është konsideruar brend ndërkombëtar. Po ashtu, e paditura ka sqaruar se Dogana është institucion ekzekutiv i cili ka për obligim që ti zbatoj vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, ku në vendimin e nxjerrë Nr.01/76 të datës 21.11.2018, me të cilin është vendosur taksa prej 100% për produktet e importuara me origjinë nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina, dhe pas analizimit të këtij vendimi, brendi i subjektit në procedurë nuk figuron si brend i cili përjashtohet nga aplikimi i taksës, pra edhe ky vendim është nxjerrë dy ditë pas importit, atëherë rezulton se mallrat e subjektit në procedurë nga Qeveria e Republikës së Kosovës nuk janë konsideruar si brende ndërkombëtare, pasi që mallrat e subjektit për tu konsideruar si brende ndërkombëtare duhet të jenë edhe në vendimin nr.01/76 të datës 21.11.2018, andaj, në këtë kuptim Dogana e Kosovës nuk ka mundur të merr për bazë pretendimet ankimore për të vendosur ndryshe çështjen kontestuese. Ndërsa sa i përket vërejtjeve të gjykatës, e paditura ka theksuar se vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.01/74 i datës 06.11.2018 dhe nr.01/76 i datës 21.11.2018 me aneks, i cili shfuqizon vendimin nr.01/74 të datës 06.11.2018 (pika 7), bazuar në qëllimin dhe fushën e zbatimit, përkatësisht vendosjen e masës mbrojtëse prej 10 % (vendimi nr.01/74 të datës 06.11.2018) dhe 100 % (vendimi nr.01/76 i datës 21.11.2018) referuar efektit të zbatimit dhe hyrjes në fuqi, për importet e realizuara me datën 19 dhe 20.11.2018 në raport me datën 21.11.2018 kur fillon së zbatuari vendimi nr.01/76 i datës 21.11.2018, nuk mund të paraqesin bazë për të përjashtuar produktet e importuara nga zbatimi i masës mbrojtëse. Ngase sipas pikës 1 që të dy vendimet e lartcekura për produkte me origjinë nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, kanë paraparë vendosjen e zbatimit të kësaj mase. Pra, duke pasur parasysh arsyet që justifikojnë ekzistencën ose qëllimin e zbatimit të kësaj mase, bazuar në vendimet e Qeverisë nr.01/74 të datës 06.11.2018 dhe nr.01/76 të datës 21.11.2018 me anekse, pavarësisht efektit të zbatimit, produktet e importuara me origjinë nga këto dy vende nuk janë përjashtuar nga fusha e

zbatimit, andaj, në rastin konkret duke pasur parasysh dispozitat obliguese të këtyre vendimeve, importet e realizuara me datën 19 dhe 20.11.2018 për brendin e prodhuar në Serbi, nuk mund të përjashtohen nga zbatimi i kësaj mase.

Gjykata konstaton se e paditura vendimin kontestues ndonëse e ka nxjerr në ri procedurë duke vepruar në zbatim të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Fiskal, A.nr.427/19 të datës 21.06.2021, ajo nuk i ka respektuar pikëpamjet juridike të Gjykatës, pra ka nxjerr vendim në kundërshtim me udhëzimet dhe vërejtjet e Gjykatës, duke anashkaluar kështu detyrimet ligjore nga neni 65 i LKA-së.

Gjykata vlerëson se e paditura sikurse në vendimin e parë refuzues për rishqyrtimin e Deklaratave Unike Doganore nr. R-68754/19.11.2018 dhe R-68759/19.11.2018 dhe R-68842/20.11.2018 të ZBD Prishtina, ka dhënë arsyetim të njëjtë sa i përket bazës ligjore edhe në vendimin e kontestuar. Sipas të paditurës, pretendimet e subjektit ankimor që mallrat të lirohen nga taksat doganore konsiderohen të paqëndrueshme dhe përpjekje e subjektit ankimor për lirim nga taksa doganore, pasi që sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.01/74 të datës 06.11.2018 është vendosur masa mbrojtëse prej 10 % për produktet nga Serbia dhe Bosnje Hercegovina, deri sa malli lëndor kontestues ka origjinë nga Serbia.

Për Gjykatën një konstatim i tillë është i pa qëndrueshëm dhe në kundërshtim edhe me udhëzimet e dhëna nga Gjykata kur rasti është kthyer në rivendosje. E paditura ka dështuar të veprojë sipas udhëzimit të dhënë me vendimin e Gjykatës me të cilin rasti ishte kthyer në rivendosje e ku e paditura ishte obliguar që të shqyrtoj pretendimet e paditësit dhe të deklarohet lidhur me provat e administruara, përkatësisht pikën 2 të vendimit nr.01/74 të datës 06.11.2018 dhe dëshmitë e ofruara nga paditësi për klasifikimin e mallit si brend ndërkombëtar që prodhohet në Serbi, respektivisht të konstatoj se përse e paditura është mbështetur në vendimin nr.01/76 të datës 21.11.2018, i cili ka qenë në fuqi në kohën kur mallrat janë importuar.

Për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata sipas propozimit të autorizuarit të palës paditëse përmes aktvendimit KF.nr.338/22 të datës 20.02.2024 ka caktuar ekspertizë financiare në këtë kontest tregtar - administrativ me ekspertin financiar J.S., e cili ka pasur për detyrë që të konstatoj se cili vendim i Qeverisë së Republikës së Kosovës për aplikim të masës mbrojtëse për produktet e importuara me origjinë nga Serbia dhe Bosnja dhe

Hercegovina ka qenë në fuqi në kohën e deklarimit dhe zhdoganimit të DUD-ave të lartcekur, saktësimin e produkteve adekuate kontestuese të importuara me DUD-at e lartcekur si dhe dokumentacionit tjetër mbështetës, të saktësoj shumën e tërësishme që paditësi rrjedhimisht i ka paguar të paditurës në emër të taksës mbrojtëse 10 % sipas vendimit të fundit në kohën e deklarimit dhe zhdoganimit të DUD-ave si më lartë për të mallit kontestues, si dhe të saktësoj përllogaritjen e kamatës për borxhin pretendues, dhe atë duke llogaritur nga dita e dorëzimit të padisë së parë në gjatë, datë 19.09.2019 dhe deri në ditën e bërjes së ekspertizës financiare.

Eksperti financiar ne ekspertizën e datës 18.03.2024 ka konstatuar se “Qeveria e Kosovës me datën 06.11.2018 ka nxjerrë vendimin Nr.01/74 për vendosjen e masës mbrojtëse prej 10 % në produktet me origjinë nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, dhe ky vendim ka qenë në fuqi deri me datën 21.11.2018, ku Qeveria e Kosovës e nxjerrë vendimin nr.01/76 me të cilin vendoset masa mbrojtëse 100% në produktet e importuara me origjinë nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina dhe e shfuqizon vendimin paraprak 01/74. Të gjitha produktet që janë importuar dhe të paraqitura në kuadër të faturave 1184615902, 1184615903, 1184618278 dhe 4/3191, si dhe të cekura në DUD-at kontestues R-68754, R-68759 dhe R-68842 duhet të përfshihen si produkte adekuate në trajtim gjatë gjykimit në kuadër të lëndës Kontestimore, pasi emrat e të gjitha këtyre produkteve janë të njëjta me brendet ndërkombëtare si Maggi, Thomy, C dhe Zvezda. Gjatë zhdoganimit të DUD-ave të lartcekur paditësi sipas vendimit Nr.01/74 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në emër të masës mbrojtëse për produktet e importuara, të paditurës i ka paguar vlerën totale prej 10,016.27 €. Në fund ka theksuar se vlera e kamatëvonesës së përllogaritur në obligimin e të paditurës ndaj paditësit sipas detyrës së dhënë me aktvendimin KF.nr.338/22 të datës 20.02.2024 është 4,070.17 €.

Gjykata e mori në tërësi si të bazuar dhe i’ a dha besimin e plotë ekspertizës së lartpërmendur, ngase e njëjta i përmban elementet e nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale, dhe arsye të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoj si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë kontest tregtar - administrativ, si dhe e njëjta është në harmoni me legjislacionin doganor të aplikueshëm.

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata vlerëson se e paditura pa bazë ligjore dhe prova materiale të besueshme nuk i ka pranuar beneficinin mbi lirimin nga taksat doganore për mallra me origjinë nga Serbia, dhe në këtë mënyrë të njëjtin e ka obliguar që të paguajë taksë shtesë si masë mbrojtëse prej 10%, kjo për faktin se mallrat e importuara dhe të cekura në DUD-at R-

68754/19.11.2018, R-68759/19.11.2018 dhe R-68842/20.11.2018, të proceduar në ZBD Prishtinë, janë brende ndërkombëtare por të prodhuar në Serbi. Prandaj, duke pasur parasysh vendimin nr.01/74 të datës 06.11.2018 të Qeverisë së Kosovës, me të cilin në paragrafin 1 është përcaktuar se “Vendoset masa mbrojtëse prej 10% për produktet e importuara me origjinë nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina”, ndërsa në paragrafin 2 të vendimit është përcaktuar se “Përjashtim nga paragrafi 1 i këtij vendimi bëjnë brendet ndërkombëtare të vendeve të tjera të cilat prodhohen në Serbi dhe Bosnjë dhe Hercegovinë”, gjykata konstaton se në rastin konkret e paditura gabimisht ka vendosur kur ka aplikuar masën mbrojtëse prej 10% për mallrat me origjinë nga Serbia të vendosur me vendimin nr.01/74 të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Andaj, gjykata ka vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke e obliguar të paditurën Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit Shoqëria “Auloni” sh.p.k, me seli në Fushë Kosovë, t’ia kthej shumën prej 10,016.27 €, të paguar më tepër në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratave Unike Doganore me nr. R-68754/19.11.2018 dhe R-68759/19.11.2018 dhe R-68842/20.11.2018, të proceduar në ZBD Prishtinë.

Gjykata konstaton se shuma e paguar më tepër në emër të detyrimeve doganore si pasojë e zbatimit të masës mbrojtëse prej 10 % e përcaktuar me vendimin nr.01/74 të datës 06.11.2018 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, u konstatua nga ekspertiza financiare e datës 18.03.2024 e ekspertit financiar J.S., sipas së cilës është bërë edhe precizimi i kërkesëpadisë në kuptim të lartësisë nga përfaqësuesi i autorizuar i palës paditëse.

Gjykata i ka vlerësuar deklaratimet dhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike kontetsimore.

Për kamatën Gjykata ka vendos duke u mbështetur në dispozitat e KDAK-së, Kodi Nr. 03/L-109, neni 292, pika b), “Në rast se çështja zgjidhet përfundimisht në instance të fundit sipas mjetit të ushtruar në favor: ((b) Të Apeluesit, Dogana duhet që: (i) të rikthejë çdo detyrim të importit apo eksportit të paguar më tepër bashkë me kamatën e grumbulluar deri në momentin e zgjidhjes së kontestit nëse është e aplikueshme”, në rastin konkret e njëjta është e aplikueshme ngase këtu paditësi e ka parashtruar si kërkesë dhe në nenet 378 dhe 382 të LMD-së, ndërsa si moment të fillimit të kamatës mori ditën e ushtrimit të padisë së parë datë 19.02.2019, e deri në ditën e përpilimit të ekspertizës datë 18.03.2024.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u parashtrua më lartë, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të 46 par. 2, 4 dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë / Departamenti Fiskal
KF.nr.338/2022, datë 03.05.2024

Zyrtare Ligjore
Amire JAHIRI

Gj y q t a r i
Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.